



TRANZICIONI I SEKTORIT TË ENERGJISË

Për më shumë se 50 vite, furnizimi me energji elektrike është mbështetur në thëngjill, resurs vendor me rezerva pothuajse të pashtershme. Termocentralet "Kosova A" dhe "Kosova B" mbulojnë pjesën më të madhe të prodhimit me energji, e një pjesë e vogël vjen nga burimet e ripërtëritshme (BRE).

Ky bilanc do të ndryshojë në vitin 2023, kur 23% e kërkesës pritet të furnizohet nga BRE-të, ndërsa prodhimi nga termocentrali "Kosova A" do të zëvendësohet nga "Kosova e Re".

Me investime shtesë, "Kosova B" pritet të operojë deri në vitin 2040. Deri në vitin 2060 termocentrali "Kosova e Re" do të mbulojë më pak se gjysmën e kërkesës për energji elektrike në vend para se te dekomisionohet dhe më nuk do të ketë asnjë termocentral me thëngjill në operim.

Edhe pse Kosova sot ka nevojë për një termocentral të ri për të garantuar sigurinë e furnizimit, e ardhmja, pavarësisht sfidave, e sektorit të energjisë në Kosovë është e orientuar kah burimet e ripërtëritshme të energjisë.

